



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:016662  
Datë: 04.06.2024  
Numri i dokumentit: 05776926

CA.nr.3156/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Naime Ahmeti dhe Enes Mehmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit-propozuesit të sigurimit N.S, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av.B.D, kundër të paditurit-kundërshtarit të masës së sigurisë A.S, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. A.Sh, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit-kundërshtarit të sigurimit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.101/24, të datës 27.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 04.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET e themeltë ankesa e kundërshtarit të sigurimit A.S dhe NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.101/24, të datës 27.02.2024 dhe gjykohet si vijon: REFUZOHET propozimi për caktimin e masës së sigurisë e parashtruar nga propozuesi i sigurimit N.S, me të cilin ka kërkuar të CAKTOHET MASA E SIGURIMIT dhe URDHËROHET kundërshtari i masës së sigurimit A.S, që menjëherë t'i ndërpres punimet, të cilat është duke i kryer në parcelën kadastrale me nr. 1628-19 ZK Gjilan dhe i ndalohet të njëjtit të ndërmarrë çfarëdo veprimi në këtë ngastrës që do të ndikonte në ndryshimin juridik dhe faktik të parcelës, e tëra kjo deri në plotfuqishmërinë e kësaj çështje kontestimore, apo deri në ndonjë vendim tjetër të kësaj gjykate.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktvendimin e ankimuar C.nr.101/24, të datës 27.02.2024, ka vendosur si vijon:

I.Apropvohet në tërësi propozimi për caktimin e masës së sigurisë e propozuesit N.S, ndaj kundërshtarit të masës së sigurisë A.S ashtu që CAKTOHET MASA E SIGURIMIT dhe URDHËROHET kundërshtari i masës së sigurimit Arben Selmani, nga Gjilani që menjëherë t'i ndërpres punimet, të cilat është duke i kryer në parcelën kadastrale me nr. 1628-19 ZK Gjilan, dhe i ndalohet të njëjtit të ndërmarrë çfarëdo veprimi në këtë ngastrës që do të ndikonte në ndryshimin juridik dhe faktik të parcelës, e tëra kjo deri në plotfuqishmërinë e kësaj çështje kontestimore, apo deri në ndonjë vendim tjetër të kësaj gjykate.

II. DETYROHEN Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë DGJKP në Gjilan dhe Noterët e Regjionit të Gjilanit, që ndalimin nga paragrafi I të dispozitivit të këtij aktvendimi, ta evidentojnë në regjistrat përkatës të tyre.

III. Ky aktvendim i dorëzohet palëve ndërgjyqëse, Odës së Noterëve të Kosovës dhe Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë (DGJKP) në Komunën e Gjilanit.

IV. Ankesa eventuale nuk e ndalon ekzekutimin e kësaj mase.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur e autorizuar e të paditurit-kundërshtarit të sigurimit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe te zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim si në ankesë.

I autorizuari i propozuesit të masës së sigurimit ka dhënë përgjigje në ankesë, me propozim që ankesa e të paditurit-kundërshtarit të sigurimit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar dhe aktvendimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës-kundërshtares së sigurimit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi-propozuesi i masës së sigurimit, përmes të autorizuarit të tij, pranë Gjykatës së shkallës së parë më datën 17.01.2024, ka ushtruar padi kundër të paditurit-kundërshtarit të sigurimit N.S, për konstituimin e të drejtës së servitutit të kalimit të përhershme, me propozim për caktimin e masës së sigurisë, të përshkruar si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar. I autorizuari i paditësit-propozuesit të sigurimit në seancën dëgjimore të datës 22/01/2024 e ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në kuptimin subjektiv, ashtu që në cilësinë e palës së paditur duhet të jetë A.S, i cili ndryshim i padis është lejuar nga gjykata e shkallës së parë përmes aktvendimit të datës 23/01/2024.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë ka mbajtur seancën dëgjimore dhe ndërgjyqësit i kanë paraqitur pretendimet e tyre sa i përket bazueshmërisë së propozimit dhe pas përfundimit të seancës gjyqësore, ka marr aktvendimin e atakuar duke u bazuar në dispozitën e nenit 297 të LPK-së dhe duke e arsyetuar aktvendimin se në rastin konkret janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të nenit 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 297 të LPK-së dhe me vlerësim ndryshe të shkresave të lëndës dhe provave të administruara, ka konstatuar gjendje tjetër faktike nga ajo e përmbajtur në aktvendimin e atakuar të gjykatës dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të administruara i ka vërtetuar drejtë faktet e çështjes, por me rastin e vendosjes lidhur me masën e sigurisë, nuk i është përmbajtur kushteve që kërkohen të plotësohen me rastin e vendosjes për aprovimin e masës së sigurimit ashtu siç rregullohen me nenin 297 par.1 të LPK-së, e cila dispozitë

parasheh se masa e sigurimit mund të caktohet: “(a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bën të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës së tij subjektive”, dhe (b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtyre pala kundërshtare do të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”. Masa e sigurisë është mjet për parandalimin e ndryshimit të gjendjes ekzistuese të kërkesëpadisë dhe kjo masë mund të caktohet po që se propozuesi i masës e bënë të besueshme të drejtën e tij subjektive dhe paraqet prova apo rrethana që e bindin gjykatën se pa caktimin e masës se sigurisë ekziston rreziku serioz se kundërshtari i sigurimit me veprimin apo mos veprimin e tij mund të ia pamundëson apo vështirëson dukshëm realizimin e kërkesëpadisë, të cilat kushte duhen të plotësohen në mënyrë komulative në mënyrë që gjykata ti ofroj mbrojtje juridike gjyqësore të përmbajtjes së caktuar sipas propozimit për masë të sigurimit.

Në rastin konkret propozuesi i masës së sigurimit nuk ka ofruar ndonjë provë konkrete se kundërshtari i sigurimit vërtet mund të pamundësoj apo vështirësoj dukshëm realizimin e kërkesëpadisë në ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do mund të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozueses së sigurimit, ngase në rastin konkret ndërgjyqësit nuk janë pronar juridik të paluajtshmeris kontestuese dhe kjo vërtetohet me ekspertizën e gjeodezisë të punuar nga eksperti L.Z si dhe të njëjtit nuk kanë ndonjë raport kontraktual me pronarin juridik, respektivisht është e pa kuptueshme se si gjykata e shkallës së parë ka ardhur në këtë përfundim që të cakton masën e sigurisë në pronën kontestuese që evidentohet në emër të N.S i cili nuk është palë në këtë kontest gjyqësor si dhe pa e vërtetuar legjitimitetin real aktiv dhe pasiv të palës. Nëse paditësi është penguar në posedimin e qetë të pronës së tij ashtu siç pretendon në padi, atëherë e drejta pozitive civile e ka paraparë procedurën e veçantë për mbrojtje gjyqësore.

Vendimi lidhur me masën e sigurisë nuk përfaqëson çështje të gjykuar e as nuk e prejudikon vendosjen e çështjes lidhur me meritat e saj.

Prandaj nga këto arsye të sipër cekura dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 208 dhe 209 pika c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

CA.nr.3156/24, me datë 04.06.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari  
Liridon Maloku